

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** Departamenti Ligjor / Drejtoria e Çështjeve Gjyqësore / Sektori i Çështjeve të Dëmeve.

SPECIALIST

Specialisti i Sektorit të Çështjeve të Dëmeve është përgjegjës për ndjekjen dhe përfaqësimin ligjor të OSHEE Group sh.a., OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a. në të gjitha shkallët e gjyqimit për çështjet që lidhen me dëmet ndaj jetës dhe pronës. Qëllimi kryesor i këtij pozicioni është mbrojtja e interesave ligjore të shoqërive në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën më të mirë ligjore.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndjek dhe përfaqëson çështjet gjyqësore për dëmet e jetës dhe të pronës, në të gjitha shkallët e gjyqimit në funksion të mbrojtjes së interesave të OSHEE GROUP SHA, OSSH SHA, FSHU SHA dhe FTL SHA.;
- Përgatitja e deklaratave të mbrojtjes, ankimeve, rekurseve dhe çdo dokumenti tjetër në funksion të mbrojtjes së çështjes gjyqësore për dëmet, ku shoqëria/shoqëritë janë palë e paditur/ palë paditëse/ person i tretë;
- Përgatit kërkesat për drejtoritë e tjera të shoqërisë/shoqërive për interpretime (teknike), prova, e të tjera, në varësi të specifikave të çështjes;
- Përgatitja e ankimeve, ankimeve administrative, rekurseve, ankimeve për kundërshtim veprimesh përmbarimore, kallëzimeve penale etj.;
- Ndjekja në bashkëpunim me DEK dhe SMP e procedurës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për çështjet e dëmeve;
- Vënia në dispozicion të Avokaturës së Shtetit e informacionit/dokumentacionit dhe qëndrimit të shoqërive për çështjet në ndjekje;
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Diplomë universitare në Drejtësi.
- Të zotërojë titullin avokat ose eksperiencë të spikatur në fushën ligjore.
- Të ketë eksperiencë pune në fusha të ngjashme (e preferuar mbi 5 vjet).
- Njohuri të mira në përdorimin e programeve bazë kompjuterike.
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe të punës në grup.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.